



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI  
OPŠTINA VUÇITRN

### PROCESVERBAL

nga mbledhja e VII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15 korrik  
2024 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:45.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehollu dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Hava Rruka Mlinaku (Nënkryetare e komunës), drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se përveç materialit të rregullt, sot kanë ardhur edhe katër pika shtesë për t'i shtuar në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtim të lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme
- Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale

Këto dy pika na kanë ardhur edhe përmes e-mailit.

Kurse, sot na erdhën edhe këto dy pika shtesë:

- Shqyrtimi i Raportit gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
- Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare të klubit të hendbollit "Samadrexha (F)".

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – lidhur me kërkesën për përkrahje financiare të klubit të hendbollit "Samadrexha (F)", tha se kërkesa ka ardhur me kohë, por nuk është bashkëngjitur me material. Kështu që, unë kërkesën e kam me vete dhe sot kam dashur që ta propozojë në mbledhje.

Ai tha se pikat që po vijnë me vonesë, po na vendosni në një pozicion të keq dhe ne jemi të obliguar që të drejtohem ty si kryesuese, sepse ti je përfaqësuesja jonë. Këto që po na vijnë në komitet, po e ka një lloj arsye, sepse po ka hapësirë që deri në kuvend të analizohen, por materialet që po vijnë në mbledhje të kuvendit, nuk ka arsye fare, sepse nuk po kemi mundësi as t'i analizojmë.

**Hava Rruka Mlinaku, Nënkryetare e komunës** – lidhur me pikat që erdhën me vonesë sot në KPF, arsyeja është se kemi dashur që t'i sjellim në KPF, e mos t'i dërgojmë direkt në mbledhjen e kuvendit. Tek rregullorja e tarifave, kjo është duke u zbatuar, por sa kam informacione, janë vetëm dy apo tri ndryshime. Prandaj, deri në mbledhjen e kuvendit ka hapësirë që të analizohen.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – deklaroi se dokumentet që kanë një peshë juridike dhe që me ligj parashihen, ato të kalojnë filtrin e KPF-së. Ai kërkoi që në seancën e ardhshme të kuvendit (të muajit korrik), mos të kemi material tjetër shtesë, e sidomos për çështje me rëndësi që na vijnë ditën e seancës dhe pak ditë para seancës. Nëse ndodh kjo, do ta kundërshtojmë një gjë të tillë, por ndoshta edhe do t'i lëshojmë punimet e kuvendit për shkak të abuzimit që ka ndodhur vazhdimisht në këtë mënyrë tash e dy-tri vite. Këto që janë sjell sot në KPF jemi në rregull, sepse nuk kanë ndonjë peshë të madhe dhe ka mjaft kohë që të analizohen. Përtej këtyre pikave, mos të ketë pika shtesë në mbledhjen e kuvendit që vijnë direkt në seancë apo para seancës, e sidomos nëse janë çështje me rëndësi, e që fillimisht duhet të trajtohen në KPF. Nuk do t'i pranojmë për aq sa kemi mundësi dhe fuqi në numra që të pajtohemi me një mendësi të tillë. Sepse, po qarkullojnë informata të ndryshme se “X” pikat po planifikohen që të vijnë direkt në kuvend, e këto pika sa kam dëgjuar janë mjaft të ndjeshme. Prandaj, po kërkoj që mos të ndodh një gjë e tillë dhe të na vendosni në një situatë të palakmueshme, sepse edhe ne përfaqësojmë dikë.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – nuk e kisha marrë krejtësisht prerazi që mos të na vijë asnjëherë asnjë pikë shtesë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

#### **R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.06.2024
  2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024
  3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2024
  4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore
  5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2023
  6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit
  7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtim të lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme
  8. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale
  9. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore
  10. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare të klubit të hendbollit “Samadrexha” (F)
  11. Pyetje dhe përgjigje
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13.06.2024.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13.06.2024.***

2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën janar-qershor 2024.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se po më vjen mirë që policia përmes kontrolleve të veta që ka bërë, e ka konfirmuar një shqetësim që e kam ngritur në

mbledhjen paraprake të KPF-së, lidhur me produktet farmaceutike, të cilat po shiten në dyqanet që gjenden në afërsi të shkollave. Prandaj, gjatë inspektimit, policia në 30 raste paska gjetur substanca narkotike (përveç tjerash), ku edhe e argumenton shqetësimin tim që e kam pasur. Shpresoj që institucionet gjegjëse, përveç policisë, edhe inspektorati i komunës të vazhdojë me kujdes të monitorojë këto hapësira, për shkak se mund nxënësit mund të bien në ndikim të tyre.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2024.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me zbatueshmërinë e vendimeve të kuvendit, do të flas për një vendim që është jashtë kësaj periudhe kohore. Institucioni i kuvendit duhet t'i shikojë vendimet e tij në mënyrë retroaktive, të cilat nuk kanë gjetur zbatueshmëri deri më tani. E njëri prej këtyre vendimeve, që fatkeqësisht po më duhet me ngrit që disa herë është moszbatimi i vendimit të kuvendit të komunës për emërtimin e teatrit "Adem Mikullovc". Ai kërkoi që të zbatohet në tërësi vendimi dhe pllaka me emërtimin e të ndjerit, Adem Mikullovc të vendoset me urgjencë në pjesën hyrëse të teatrit.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – lidhur me vendimin e shujtave për punëtorët e administratës së komunës, ai pyeti se a është kthyer ligjshmëria e këtij vendimi.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se ende nuk na është kthyer ligjshmëria e këtij vendimi. Kemi pyetur disa herë edhe përmes telefoni, por përgjigjja e tyre është se ka kaluar në Ministrinë e Financave dhe është lënda tek ministri.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor Financiar dhe Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – lidhur me raportin e auditimit, ai tha se është një lajm i hidhur për komunën tonë, ku kemi gjetje të shumta, një raport që është i kualifikuar dhe në kushte normale, kjo është një pistë e hapur për hetuesinë, për atë se çfarë ka ndodhur. Kjo është shqetësuese dhe meriton trajtim më të gjerë. Nuk po e di se pse komuna i ka bërë gjithë këto shkelje, ku jemi në një situatë shumë më të favorshme sesa vite më parë. Jo shumë larg, komuna kishte vetëm 190 mijë euro subvencione dhe ka qenë ndoshta e detyruar të bëjë keqklasifikim për t'i realizuar disa projekte jetike për komunën, qoftë në bujqësi, qoftë në shëndetësi. Kurse, sot nuk jemi në situatën e njëjtë, sepse kemi afërsisht dhjetëfish më shumë subvencione dhe kemi aq shume keqklasifikime. Pastaj, gjetjet skandaloze që kanë ndodhur nëpër konkurse, mospagesa e qirave për pronat publike, ndarja e mijëra eurove për OJQ që nuk kanë aplikuar fare ose kanë aplikuar me vonesë (ligji e thotë qartë që çdo aplikacion që vjen pas kohe – refuzohet). Këto janë të gjetura serioze që dikush është dashur të jep përgjegjësi, sepse disa prej tyre janë të pafalshme, të palogjikshme dhe të paarsyetueshme. Të merr guximin dikush t'ja ndajë 15 mijë euro një OJQ-je që nuk i plotëson kriteret ose që nuk ka dorëzuar fare raport financiar apo, t'i ndajë mjete një OJQ-je që nuk ka aplikuar fare, dhe të vendosen mbi ligjin, pa e qarë fare kokën. Pastaj, lidhur me borxhet ndaj komunës nga ana e shfrytëzuesve të pronave komunale, ne e kemi parë në kuvend raportin e komisionit që ka folur edhe për këto borxhe. Komuna, në

vend që të ndërmerr masa në këtë drejtim në gjenerimin e të hyrave financiare, nuk kanë marrë asnjë veprim. Edhe mosveprimi në këtë rast është keqpërdorim i pozitës zyrtare për ata menaxher të kontratave, që kanë qenë të obliguar t'i zbatojnë ato kontrata.

Komuna e Vushtrrisë ka qenë e renditur lartë viteve të fundit, së paku në top dhjetëshe dhe të bie në situatë të tillë, në pozitën e parafundit prej 38 komunave, nuk do koment. Nuk po e themi këtë ne si opozitë, po e thonë institucionet e pavarura: Zyra Kombëtare e Auditimit, USAID, mediat, e kështu me radhë. Situata është e rëndë, shpresojmë që kryetari i komunës do ta merr përgjegjësinë për këto dështime dhe do ta paguajë faturën në fund të mandatit.

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se auditimi është bërë sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik. Por, arsyeja se pse kemi marrë opinion të kualifikuar është se ka ndikuar edhe inflacioni i arsimit në këtë çështje. Ai tha se jemi 5 komuna që nuk kemi mundur t'i marrim pasqyrat e pakualifikuara për shkak të inflacionit të arsimit. Ai tha se edhe nëse është opinion i pakualifikuar, prapë ka rekomandime. Ai tha se raporti ka rezultuar me 27 rekomandime, prej tyre 9 janë rekomandime të reja, kurse 18 janë rekomandime të përsëritura, që ende nuk kemi mundur t'i procesojmë, sepse kemi projekte trivjeçare.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Komunal të Aksionarëve i N.P.L. “Përparimi” SH.A për vitin 2023.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – kisha kërkuar nga komisioni që të na informojë në seancën e kuvendit për të gjitha kontratat që i kanë lidhur me kompanitë e ndryshme private pas vitit 2023, pasi që punëtorët e “Unitetit” kanë kaluar në NPL “Përparimi”. Pra, të na i sjellin këto kontrata dhe të na informojnë se çfarë ka ndodhur.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tha se e para, ky material na ka ardhur me vonesë, e dyta është një diskrepancë e madhe e formës së raportimit në mes të vitit paraprak dhe tani, në përbërje dhe në cilësi. Sepse, për vitin paraprak kanë folur për shërbimet e kryera nga kjo ndërmarrje, kurse ky material që na ka ardhur për këtë periudhë, është një dokument i orientuar tek pjesa legjislative e funksionimit të ndërmarrjes. Ku, listohen disa kontrata, rregullore, marrëveshje dhe se tregon për disa aktivitete në tituj, se sa janë kryer, sa janë paguar, sa janë shpenzuar, si kanë ndryshuar çmimet. Pra, nuk kemi një informatë të detajuar, psh. për mjetet që ua ka ndarë kuvendi i komunës (edhe pse ne nuk e kemi votuar). Ku kanë mbetur këto mjete? Pra, është dashur të informohet kuvendi për mjetet që ua ka ndarë se për çfarë janë shpenzuar. Pastaj, investimet kapitale që i ka realizuar gjatë kësaj periudhe, po e shohim që janë blerë makineri në kundërshtim me ligjin dhe të prishura, jo funksionale, me mbi 30 vjet, kurse janë blerë me çmime të majme dhe se operatori furnizues ka qenë me veprimtari që mbjell lule.

Në faqen 9, titulli është “Numri i punonjësve në NPL “Përparimi” Sh.A – 31, dhjetor 2023”, kurse tabela nr . 4 emërtohet “Puna e Komisionit Komunal të Aksionarëve” dhe flitet për kategorinë e punëtorëve se ka sa punëtorë janë. Çka ka të bëjë kjo punë e komisionit me këtë kategori të punëtorëve. Pastaj, në faqen 12, pika 15 “Largimi i deponive ilegale”. Sa deponi ilegale janë larguar? Në cilat vende janë larguar? Nuk flitet në detaje. Po ashtu, mungojnë marrëveshjet dhe aneks-marrëveshjet, kontratat, që i përmendi Agroni. Neve na interesojnë shërbimet se qysh janë ofruar, gjendja e funksionimit të ndërmarrjes, ka vonesa të pagave, sepse po punësohen njerëz përmbi kapacitetet e ndërmarrjes, gjenerimi i të hyrave e shumë gjër tjera.

Ky raport është i mangët dhe ka nevojë që të plotësohet dhe se nëse do e kisha pëlqimin e kolegëve nuk e kisha proceduar në kuvend pa e plotësuar, sepse ky nuk i plotëson kushtet që të trajtohet si raport. Ky është një përshkrim i bazës juridike të ndërmarrjes.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – tha se unë jam e mendimit që t'i dërgohet rekomandim nga komiteti, e jo që mos ta procedojmë, sepse qe sa e kemi pritur dhe është shtyrë ky raport.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri me plotësime rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me mbrojtjen e mjedisit.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – pasi që lidhet me çështjen e mjedisit, ai tha se në muajin maj ka pasur që të përpilohet Plani Zhvillimor Komunal dhe se ende nuk na ka ardhur. Na patën premtuar që edhe si assemble do ju ftojme për të marrë pjesë në konsultim publik. Komuna po funksionon pa një plan zhvillimor që sa vite. Ai kërkoi që deri në seancë, drejtoria të na njoftojë se pse nuk është kryer dhe deri ku kanë shkuar procedurat.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtim të lapidarit në fshatin Dumnicë e Poshtme.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

8. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 02/2023 për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

**Hava Rruka Mlinaku, Nënkryetare e komunës** – sa kam informacione, janë bërë disa ndryshime të vogla në Drejtorinë për Administratë, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale dhe në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se sot nuk e kemi të pranishme kryesueses e komisionit, por në mbledhjen e kuvendit do të jetë e pranishme për të dhënë sqarime.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – tek neni 8 “Tarifat në sferën e shërbimeve publike”, nuk e di si kanë qenë çmimet më herët. Psh. tek paragrafi 8.2.5 “Leja për prerjen e asfaltit në rrugë për metër katror – 70€”, ai propozoi që kjo shumë të rritet, sepse duhet të vetëdijësohen njerëzit e mos ta prejnë asfaltin pa nevojë. E vetmja mënyrë e vetëdijësimit është që të rritet tarifa. Ky çmim duhet të jetë ekuivalent apo më shumë me tarifën me pajisjen për vendosjen e gypave nën asfalt.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – dua të ndalem tek neni 11 “Tarifat në sferën e sportit”. Nuk kam arritur ta lexoj me kujdes draftin e rregullores, sepse na ka ardhur me vonesë, por për mua janë të papranueshme vendosja e këtyre tarifave. Pyetja është: A vlejne këto tarifa për të gjitha klubet? Sepse, ka klub që nuk subvencionohet fare. Pastaj, ka klub që subvencionohet pa aplikuar fare. Nuk po e kuptoj pse t’iu vendosen tarifa klubeve, a në vend që të hiqen tarifat krejt e të stimulohen. Gjithmonë palestra është shfrytëzuar pa

pagesë. Pastaj, tek biblioteka “Naim Frashëri”, pagesa për fëmijë ka qenë pa pagesë, kurse tash është vendosur tarifë. Pa pagesë nuk kemi pasur lexues, se jo tash me pagesë. Ajo kërkoi që të rishikohen këto tarifa.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – ai tha se sporti nuk është duke u menaxhuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Kishim një dëgjim buxhetor me sportistë dhe ata i paraqiten pakënaqësitë e tyre dhe sa u pa nuk ka një komunikim si duhet me sportistë nga drejtoria. Drejtoria nuk e di sa klube ekzistojnë, cilat klube marrin pjesë në gara evropiane, ndërkombëtare. Një pakënaqësi në atë takim ishte se ka klube që subvencionohen nga komuna dhe nuk marrin fare pjesë në gara. Ai kërkoi që Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ta caktojë një person që të komunikon me klubet sportive. Palestra e sporteve është në gjendje të mjerueshme dhe tash e sa vite është ende pa përgjegjës.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që me sugjerime dhe plotësime të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

9. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – edhe pse na erdhi me vonesë, ajo që është shqetësuese është se shumica e projekteve kapitale janë zero në realizim dhe shpenzim. Siç e shihni në tabela, investimet kapitale shumë pak kanë ecur. Besoj që deri në seancë do të kemi kohë që ta analizojmë këtë raport.

Ai kërkoi nga drejtori informatë se cilat projekte ka shpresë se do të realizohen sivjet apo në cilat projekte është duke u punuar.

Ai deklaroi se investimet kapitale në shëndetësi, ndryshe janë votuar në kuvend e ndryshe po veprohet. Ai kërkoi përsëri draftin e buxhetit se qysh është votuar në kuvend (investimet kapitale në shëndetësi) dhe qysh është gjendja aktualisht.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – e tha edhe parafolësi që shumica e tabelave janë zero, pra ende janë projektet pa filluar. Jemi në muajin korrik, kurse në muajin shtator/tetor veç mbyllën kodet buxhetore dhe janë vështirë të realizueshme. Në këtë tabelë që na është sjellur, janë gjithsej 238 projekte, ku prej tyre vetëm 58 projekte kanë filluar, ndërsa 180 projekte janë ende pa filluar (zero). Kërkoj një sqarim se kur po mendoni që t’i kryeni këto projekte që janë planifikuar për këtë vit dhe që nuk kanë filluar ende?

**Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa** – tha se sa i përket raportit gjashtëmujor është një trend dhe një realizim i mirë, krahasuar me vitet e kaluara. Ndërsa, sa i përket projekteve, ju e dini që në kuvend është marrë një vendim për ridestinim të mjeteve të lira për shkak të inflacionit në arsim dhe mjeteve që na u kanë marrë nga projektet, të hyrat e bartura. Pra, këto mjete që janë ridestinuuar, i kemi fokusuar në 60 projekte për sivjet.

***Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.***

10. Shqyrtimi i kërkesës për përkrahje financiare të klubit të hendbollit “Samadrexha” (F).

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – deklaroi se përmes kësaj kërkesë, klubi e ka paraqitur një shpenzim prej 42 mijë euro, kurse nga komuna ka kërkuar 30 mijë euro. Kërkesa është paraqitur edhe në drejtori, është shqyrtuar, por nuk

është përcaktuar shuma financiare. Kështu që deri në mbledhjen e kuvendit, kryetari në bashkëpunim me drejtorinë do të vendosin për shumën financiare se sa kanë mundësi ta përkrahin klubin.

**Agron Perçuku, anëtar i KPF-së** – tha se KH “Samadrexha” (F) këtë vit kanë shfaqur gara të mira dhe me këtë sukses të treguar ka arritur që të kualifikohet për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare. Prandaj, është kënaqësi dhe krenari të përkrahet financiarisht një klub i tillë që do të merr pjesë në gara evropiane, si dhe është obligim i komunës që t’ju qëndroj prapa për shkak të ecurisë dhe mbarëvajtjes në mënyrë që të mos tërhiqet nga garat (një gjë të tillë e ka kërkuar federata). Kërkesa e tyre është simbolike, sepse shpenzimet tjera i mbulon klubi me donatorë. Kërkoj nga kryetari dhe drejtori i financave që në seancën e kuvendit të vijnë me propozim-vendim për përkrahje financiare.

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së** – dua të ju informojë se përveç traditës që ka klubi, gjatë konsultimeve me udhëheqjen e klubit e kuptova që klubi “Samadrexha” (F) e ka golashënuesen më të mirë në Kosovë.

**Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së** – fshati Samadrexhë është njëri prej lokaliteteve më ikonike në Kosovë, sa i përket sportit të hendbollit dhe se është një relik i komuna duhet ta mbrojë. Ne e mbështesim kërkesën e klubit për përkrahje financiare. Por, ta largojmë vëmendjen nga kjo kërkesë. Mendoj se ka ardhur koha që për shkak të të gjeturave të auditorit të vendoset rregull për mënyrën e subvencionimit. Ka një rregullore, e cila parasheh subvencionimin përmes thirrjes publike, ku klubet konkurrojnë për mjetet financiare që i synojnë dhe kanë nevojë.

**Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së** – tha se kjo kërkesë erdhi me vonesë, por u mundova që ta analizojë. Dua të ju njoftojë se klubet kur marrin pjesë në gara ndërkombëtare, jashtë vendit, Federata dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e ka obligim që ta financojë klubin, për shumicën e këtyre kërkesave që klubi i ka bërë këtu. Jam që ta përkrahim këtë kërkesë të klubit, por pasi që nuk qenka kërkesa urgjente, atëherë është mirë që të përkrahet përmes thirrjes publike dhe të ndjekin procedurat, ashtu qysh e parasheh rregullorja.

*Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

11. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

**Bujar Klinaku**

  
Procesmbajtës

**Melihate Basholli - Latifi**

  
Kryesuese e KK-së dhe KPF-së

